

nr/01-419

22.07.2019

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo



KUVENDI KOMUNAL-SKUPSTINA OPSTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë e rregulltë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 27.06.2019, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi Nebojsa Arsic, zv.Kryesuesi Ramush Mehmeti, Nënkryetari për Komunitete Bajrush Ymeri, anëtarët e Kuvendit: Ivica Cenic, Mirjana Simijonovic, Jorgovanka Filic, Dragana Dimic, Abdyl Gashi, Negovan Jovanovic, Milica Jovanovic, Selatin Nuhju, Dobrivoje Djordjevic, Predrag Stojkovic, Zymer Zymeri, Jahi Zeqiri, Drejtori i Financave Sercan Todorovic, Drejtori i Administrates Driton Abdyli, përfaqësuesi i OSBE-es, zyrtar dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit Nebojsa Arsic pasi përshendeti të pranishmit tha: para se të fillojmë me mbledhjen duhet konstatuar korumin prezent janë të gjithë antarët e Kuvendit dhe kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojmë mbledhjen me këtë:

Rend dite

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Shqyrtimi dhe Aprovimi i propozimit të Kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB) 2020-2022;
3. Formimi i Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
4. Raportimi i njësis Komunale të EccoHigienes për aktivitete e ndërmarrura me 01-06.05.2019;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i pyeti të pranishmit se a pajtohen me këtë rend dite apo keni ndonjë propozim?.

Pasi nuk pati propozime rendi i ditës u aprovua njëzëri nga të gjithë antarët e Kuvendit.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Abdyl Gashi pasi përshendeti të pranishmit tha: kam vërejtje për shkak se disa fjalë po thuajse po mundohet me nxerr thelbin por disa fjalë nuk janë të shkruara në procesverbal, mos të detyrohemi me ingjizim e pastaj me ja dërgu sekretares, por unë mendoj se komplet fjalën deri në fund qoftë keq apo mire duhet me u shkru në procesverbal.

Xhejlane Behluli tha: unë e kam vetëm një kërkesë, një permirsim kur kam fol për lagjen posht ka qenë fjala për lagjen Kalabria pasi që nuk është e cekt.

Pasi nuk pati tjera diskutime me 11 vota për, 3 apstenime dhe 1 nuk ka votuar aprovohet procesverbal i mbledhjes së kaluar.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe Aprovimi i propozimit të Kornizes Afatmesme Buxhetore (KAB) 2020-2022;

Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Drejtorit Financave Sercan Todorovic.

Sercan Todorovic pasi përshendeti të pranishmit tha: materialin e KAB 2020-2022 e kemi marrë më kohë dhe kjo korniz është për vitin e ardhshëm, ne në fillim e kemi pranuar qarkoren buxhetore nga Ministria

dhe në bazë të kësaj qarkore e kemi pregaditur KAB. Buxheti në total për vitin 2020 është 2,905,633 €, grantet totale i kemi 2,663,154 €, ndërsa të planifikuara nga të hyrat vetanake janë 242,479 €. Për paga dhe medijtje janë planifikuar të shpenzohen 2,208,143 €, për mallra dhe shërbime 221,335 €, për shërbime Komunale 69,259 €, për Subvencione 56,725 dhe për investime kapitale 350,171 €. Aty i keni shenimet edhe për vitin 2021 dhe 2022 por nuk kam nevoj ti lexoj të gjitha pasi që do të punojm më von për ato ndërsa tani për tani do të punojm të gjithë së bashku për buxhetin e vitit të ardhshëm që është 2020. Ju faleminderit, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti pasi pershendeti të pranishmit tha: sa i perket kësaj pike materialin e kemi marrë me kohë por pyetja e parë që ja bëjë Drejtorit është se a ka mbajtur debate publike?, pasi që në bazë të ligjit është obligativ mbajtja e degjimeve publike, pasi që në faqen e parë shkruan qartë se ky dokument do të jetë baza për percaktimin e sektorëve primarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shperndarjes se burimeve finale për periudhen 2020-2022 pra është një dokument shumë bazë andaj duhet ta analizojmë mirë. Drejtorit i kam sugjeruar edhe më heret te planifikimi i numrit të bizeseve, numri i popullësisë po shkon çdo herë me të njeften shifer dhe mendoj se kjo është gabim, logjikisht duhet të jet ose një ngritje aktuale e lehtë ose një rënjë e lehtë. Te nderuar antarë të Kuvendit tju them sinqerisht e kam shfrytëzuar këtë material në detale dhe e kam parë se për vitin 2020 është aprovuar ligji i pagave dhe me ligjin e pagave rritje më së shumti ka sektori i Kuvendit dhe Drejtoria e financave e ka derguar buxhetin e njejt si për këtë vit ashtu edhe për vitin e ardhshëm ndërsa në Drejtorin për infrastruktur i ka parap për paga dhe medijtje 96,985.00€ dhe bëj pyetje se sa punëtor i ka kjo Drejtoria?, kjo shumë është marramendese, më së shumti që ka buxhet për paga dhe medijtje është Drejtoria e infrastruktures me 96,985.00€ ndërsa Kuvendi me 15 antarë i ka vetem 70,000€, me një kalkulim të thjesht ne si Kuvend duhet ti kemi 130,000€ buxhet për paga dhe medijtje per vitin 2020, nese i kemi 130,000€ buxhet ne mund të marmi pagat me rritje perndryshe me shumen prej 70,000€ i marmi pagat ashtu si deri sot, dmth ligji kot u aprovuar dhe nese ne si Kuvend e aprovojme këtë qarkore buxhetore po pajtohemi që të vazhdojm me paga të njejt, andaj unë po kërkoj ng ju që këtë qarkore buxhetore të mos e aprovojme pasi që ka edhe gabime maramendese e mos të hy ne detale me analizu dhe qështja tju kur ka tema kaq të rendesishme e të mos jet Kryetari i Komunës, andaj kërkoj nga të gjitha partit të kenë kujdes pasi që ne mundë të votojm e mundë të mos votojmë, ju faleminderit.

Sercan Todorovic tha: debatet publike i mbajm gjatë muajit korrik dhe gusht, kjo korniz buxhetore është vetem fillimi i planifikimit buxhetor ndërsa buxheti final aprovohet në shtator, pagat dhe medijen në infrastruktur publike janë të planifikuara edhe në vitin e kaluar, e di se është aprovuar buxheti edhe për shërbysit civil por ne kemi punuar në bazë të qarkores buxhetore.

Ramush Mehmeti tha: p.sh në administrat të pergjithshme janë 190,000€ në rregull është pasi që administarta ka numër të madhë të puntorëve edhe në drejtori tjera janë në rregull por në infrastruktur kjo shumë është ndar pa u llogarit.

Sercan Todorovic tha: kjo është vetem një fillim i kornizes buxhetore, do ti kemi debatet dhe të gjitha projektete dhe buxhetin e detajuar në shtator ateher edhe kur do të aprovohet.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 5 vota për 9 kunder (nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Dobrivoje Djordjevic) dhe 1 apstenim nuk aprovohet KAB 2020-2022.

Pika e tretë: Formimi i Komitetit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);

Kryesusi tha: nga zyra e Kryetarit na ka ardhur një kërkesë për formimin e KKSB-së dhe me këtë e kemi marr edhe propozim vendimin me emrat e antarëve të KKSB-së dhe pozitat e tyre, është hera e tretë që e kemi marrë këtë vendim, e dini se për formimin e KKSB-së është udhëzimi administrativ që e rregullon formimin dhe perbërjen e këtij komiteti, kemi pasur diskutime me heret se Nënkryetarët e Komunës nuk duhet të jenë pjesë e këtij komiteti, për mos të pasur paragjykime se ne nuk po deshirojm ta formojmë këtë komitet po e hapi diktutin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: Kryesues ne më heret e diskutum kornizen buxhetore dhe aty nuk parashihet ky komitet ne buxhet andaj edhe nuk duhet të formohet, Kryetari e ka mbajt peng që 1 vit e gjysëm këtë komitet dhe nuk e ka formuar, problemi është që në si Kuvend mos të dalim si Kuvend loje dhe nese nuk sigurojm buxhet mos të formojm, e di se ka kerksa prej Ministrisë dhe OSBE-së që ky komitet të formohet por e din të gjithë se si në mandatin e kaluar nuk janë paguar, nese Drejtoria e Financave nuk parashihet buxhet si do të paguaj këtë komitet atëher ne si ta formojmë, së pari duhet të sigurohet buxheti, andaj nuk jam për me votu këtë listë, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: besoj se është mirë me ma respektu fjalën kur e kerkoj fjalën i pari apo i dyti ashtu me radhë, mendoj se po bëhen kopje me individ të caktuar për formimin e këtij këshilli që është këshill i jashtzakonshëm dhe është duhur moti të kryhet dhe Kryetari ish dasht me ardh dhe me prezantu një list të tillë dhe për secilin individ me dhënë një arsye pasi që bëhet fjal për një këshill për siguri dhe dihet si është gjendja e sigurisë ne vend këtu të na dihet se ka vjedhje për çdo muaj dhe është bërë si tradicionale e krejt normale, prap futen njerzët që i konsiderojn si militant partiesh apo njerzët që sigurojn vota gjatë fushates zgjedhore dhe kjo është e papranueshme edhe për mu që kjo list me këta emra me kalu perderisa edhe se kemi prezantuesin e kësaj liste që e ka formu, le të vij Kryetari dhe të prezantoj secilin antarë dhe le ti jep arsyetimet se pse janë këta dhe e mirë kishte qenë që Kryetari të bëj prezantimin, Kryesuesi e lexoj por Kryetari i ka emruar këta, besoj se kjo list nuk duhet të kaloj pasi që nuk duhet të formohet një komitet vetem sa për sy e faqe për ta mbuluar për arsye se Kryetarit ndoshta ka presionin prej nivelit qendror për ta formuar këtë komitet dhe kjo nuk bënë më kalu në këtë seanc, ju faleminderit.

Drejtori i Administrates Driton Abdyl pas pershendeti të pranishmit tha: nuk e kam marrë fjalën as me kerku me votu e as me arsyetu Kryetarin por kam qenë Nënkyetar i Komunës gjatë viteve 2010-2014 dhe kur ka qenë Minister i brendshëm Bajram Regjepi nuk e di se a ka ndryshuar kjo por ai na ka thënë se Nënkyetarët duhet patjetër me qenë antarë të KKSB-së për arsye se Kryetarët po qendrojnë shpesh jashtë vendi e nuk kanë mundësi me marë pjesë, sa i perket Ramushit e di se në mandatin e kaluar ke qenë antarë i KKSB-së dhe atëher nuk i permendshe paret dhe asnjëher nuk tkan ndrru çdo here ke qenë ti antarë i KKSB-së.

Ramush Mehmeti tha: ligji shumë qartë thot se kush mundet me qenë antarë e kush jo në KKSB, mua po me pengon mungesa e prezantuesit pasi që lista mundë edhe të permirësohet.

Nënkyetari për Komunitete Bajrush Ymeri pas pershendeti të pranishmit tha: meqë mu permend emri e kam një reagim, natyrisht në udhëzimin administativ nuk ceket që duhet me qenë edhe Nënkyetarët pjesë e këtij komiteti por atë qe e tha Drejtori i Administrates është shume e vertet pasi që shumë herë kemi pasur kërkesë prej Ministrisë së Punëve të Brendshme që me i angazhu Nënkyetarët për arsye që shumë herë Kryetarët për arsye të angazhimeve që i kanë nganjëher edhe udhëtimeve jashtë vendit dhe në mungesë të Kryetarit duhet ditur se kush po e udhëheq atë KKSB, mundë të kemi situata të jashtëzakonshme për këtë arsye edhe Kryetari e ka parë të nevojshme që edhe ne të jemi pjesë e KKSB-së pasi siç e dini edhe nese vazhdohet me pagesë të meditjeve ne si Nënkyetar dhe të gjithë ata që marrin pagë nuk paguhen, vetem se qëllimin e kemi të mirë në mënyrë që të dhëjmë kontribut aty e asgjë tjetër, ju faleminderit.

Pasi nuk pati tjera diskutime Kryesuesi e hudhi në votim këtë pikë.

Me 6 vota për, 9 kunder (Nebojsa Arsic, Ramush Mehmeti, Abdyl Gashi, Selatin Nuhiu, Mirjana Simijonovic, Milica Jovanovic, Ivca Cenik, Dragana Dimic, Dobrivoje Djordjevic) nuk aprovet Vendimi për formimin e KKSB-së.

Pika e katërt: Raportimi i njësis Komunale të EccoHigienes për aktivitete e ndërmarrura me 01-06.05.2019; Për këtë pikë Kryesuesi ja dha fjalën Menaxherit të Kompanis EccoHigiena Naser Ibrahim.

Naser Ibrahim pas pershendeti të pranishmit tha: ju falenderoj që më keni përkrahur në marrjen e vendimit për enkasimin e mjeteve me datë 1-09 Maj andaj e kemi për obligim që të raportojm se sa mjete janë mbledhur dhe ku janë shpenzuar. Të gjitha mjetet janë dorzuar në arkë ku me material i keni të gjitha dhe nuk ka pasur asnjë mundësi që të keqperdoren, gjithashtu është paguar edhe tatimi për ato

Procesverbali i Kuvendit

mjete të mbledhura, me datën 1 Maj janë inkasuar 1150€ me datën 6 Maj janë inkasuar 140€, këto mjete që janë mbledhur janë përfshi disa shpenzime si ushqimi i punëtorëve dhe policive që kanë marrë pjesë atë ditë, si dhe janë paguar 30 punëtorë që kanë bërë pastrimin e këtij teritori dhe prej krejt këtyre mjeteve kanë mbetur 380€ ndërsa të tjerat janë paguar ushqim dhe medita, në raport me material e keni më gjersisht të gjitha nese keni ndonjë pyetje urdhëroni, ju faleminderit.

Kryesuesi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesi e falenderoi zt.Naserin për raportin e paraqitur.

Pika e pestë: Të ndryshme.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Ramush Mehmeti tha: në këtë pikë e kam një propozim konkret që të shkojm në një vizit pune në Mal të zi me 2 shtator pasi që e kanë seancën e Kuvendit të takohemi me antarët e Kuvendit të Ulqinit pasi që është edhe Kuvend multietnik të diskutojm se si ipen prioritetet e listave të projekteve, të marmi pak mësim edhe prej tyre por njëherit të bëjmë edhe vizitë në vende të ndryshme në Mal të zi, propozoj sot në mënyrë që të kemi kohë pasi që së pari duhet të aprovohet nga MAPL-ja nese është në harmoni me ligjin e pastaj të kryhen procedurat e prokurimit që të shkojm në vizitë 3-4 ditë pasi që ne pas miratimit të buxhetit në shtator jemi obligativ Kuvendi ta mbajm një debat publik me qytetar e për këtë arsye të kemi kohë të mjaftueshme, andaj nese jeni të pajtimit duhet të vendosim në këtë mbledhje dhe ne nuk kemi mundësi të marrim më shumë vetëm antarët dhe stafin e Kuvendit, ju faleminderit.

Kryesusi e hapi diskutimin për këtë pikë.

Zymer Zymeri pasi pershendeti të pranishmit tha: unë konkretisht e përkrahi Ramushin që të shkojm ne jashtë shtetit dhe të vizitojm Kuvendet e tjerë që të shikojm se si punojnë.

Xhejlane Behluli tha: e përkrahi edhe unë këtë propozim por nuk e di sa i perket përkrahjes financiare se sa do të marrim prej Kryetarit apo po mendoni me buxhet t'Kuvendit por sa kemi ne buxhet më duket se shumë pak, si iniciativ është shumë e mirë dhe pajtohem sa i perket zyrtarëve por mos të ketë zavitendësime, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: më vjen keq më duhet të apstenoj pasi që nuk e shoh agjenden se ku kemi me shku, cilat vende kemi mi vizitu, prioritetet tona se çka do të diskutojmë përndryshe me bërë të njëjtin gabim e me shku me bë plazh atje sikur më heret nuk e shoh të arsyeshme, por pse jo të mos marmi përvoja edhe nga Komunitat e tjera vetëm me pas një agjendë.

Ramush Mehmeti tha: po pajtohem plotësisht por unë kam kërkuar edhe nga OSBE-ja që të na ndihmoj por nese ne e marmi vendimin dhe MAPL-ja na konfirmon unë kisha propozu në muajin korrik që të formohet një komision prej Kuvendit prej 3 antarëve në mënyrë që kur ta shpallet tenderi të dim çka po dojm dhe me bë agjendën.

Jahi Zeqiri pasi pershendeti të pranishmit tha: kërkoj një sqarim nga Ramushi për vitet e kaluara sa herë kanë shkuar kanë marr pjesë në vizita të ndryshme a ka pas një herë naj deshmi që është punu diçka për të mirën e qytetarëve të Komunitës së Novobërdës?, pse zgjedhet Mali i zi kur është Shqipëria ku është më afër dhe më pak e kushtueshme?

Ramush Mehmeti tha: ne çdo here kemi mbajtu takime kur është diskutuar qarkorja buxhetore, ne jemi Komunitat multietnike ne mundë të shkojm të ndalemi edhe në Shqipëri, ne së pari duhet ta biem vendimin pastaj formohet komisioni dhe e bënë agjendën, ne kemi mundësi me vizitu edhe komunën e Shqipërisë dhe të Malit të zi e kemi mundësin pse mos me shfytëzu, ju faleminderit.

Jahi Zeqiri tha: pse nuk diskutohet diçka tjetër pasi që ka shumë sene me më rëndesi se sa me shku me vizitu një vend, pasi që secili i ka mundësit edhe vet me shku me vizitu pa Kuvend hiq pasi që secili antarë i Kuvendit i ka mundësit finciare me shku e kjo mu dikutu këtu është shumë absurde.

Dobrivoje Djordjevic pasi pershendeti të pranishmi tha: nuk pajtohem me këtë propozim pasi që ka qështje tjera që Kuvendi duhet ti rregulloj, edhe nese mesojm nga përvoja e tyre atje ne perseri punojmë ashtu siç po dojm.

Procesverbali i Kuvendit

Xhejlane Behluli tha: koleg sa e di unë buxhetin të cilin e kemi në Kuvend nuk mundemi që të bëjm kalime buxhetore nëpër kode kështu që më mirë më shfytëzu, ne mundemi edhe hiq mos të shkojm e mundemi me shku edhe me paga tona por e ka treguar një rast Kryesusi ku nuk i ka shpenzuar të gjitha mjetet, ju faleminderit.

Jahi Zeqiri tha: Xhejlani po thot se duhet të shpenzohet mjetete e Kuvendit por besoj që Kuvendi ka shumë mundësi se ku ti shpenzoj këto mjete.

Kryesusi tha: nuk mundet me qenë privat pasi që nese shkojm privat nuk mundet me qenë vizita zyrtare atje.

Driton Abdyli tha: nese Kuvendi vendos me shku so problem por atje ka edhe administratë, sherbime publike, unë e kam një vërejtje zt.Ramush pasi që shpesh herë je thirr në parime, jo të dim se çka po votojm mirëpo shumë mirë të tha Abdyli por ti propozove me votu diçka pa ligj, e Drejtorat i kritikojshe dhe mua me ke thën se ne duhet të dim se çka po votojm së pari duhet të bëhet agjenda se do të shkojmë këtu në këtë vend edhe as nuk tregove se ke biseduar më Kryetarin e asaj Komune.

Ramush Mehmeti tha: faleminderit Drejtor për këto sygjerime që po i jep por unë shumë qartë e thash që së pari të mirret një vendim, të formohet një komision e pastaj ta bëjm agjenden por së pari ky vendim të aproovhet nga MAPL-ja.

Naser Ibrahimimi tha: unë e kam një vërejtje dhe kisha pas deshir që të jetë edhe Kryetari këtu, unë jam zgjedhur përfaqësues i fshatit Pasjak dhe çdo herë është bisedu që kur të rregullohet diçka në fshat të pytet përfaqësuesi i fshatit e kjo nuk po ndodh, ne na ankohen qytetarët për rrug e probleme të ndryshme ndërsa kur bëhet ndonjë investim në fshat nuk pytet përfaqësuesi i fshatit, çdo investim në fshat ne e mirëpresim edhe nese del Kryetari, antari i Kuvendit ose qytetarët e jo të del Bajram Abazi e unë si përfaqësues mos me u njoftu hiq pasi që nese jam zgjedhur nga ju duhet të respektohem ose merreni vendim dhe shkarkoni kryesin e fshatrave pasi që nuk pyeten e vjen ky zyrtar e shkakton perqarje.

Xhejlane Behluli tha: po nderlidhem me këtë diskutimin e fundit pasi edhe ne jemi të zgjedhur prej popullit dhe kur kemi pasur takime të ndryshme si takime buxhetore është thën çdo herë që antarët e Kuvendit mu u njoftu kur ka investime kapitale, sa i perket përfaqësuesve të fshatrave ti hapmi syt në mandatet e ardhshme kur të zgjedhen në të ardhem mos të zgjedhen politikishtë por le ta merr dikush pozitën që me të vertet punon, unë jam për me perkrah çdo investim që është për të miren e qytetarëve, ju faleminderit.

Naser Ibrahimimi tha: Kryesus unë nuk e ceka as Kryetarin e as antarin e Kuvendit për mos me dal ne vend të ngjarjes por unë kerkoj që të bashkpunojn me përfaqësuesin e fshatrave.

Ramush Mehmeti tha: Naser ki të drejt plotësisht por problemi është të Kuvendi pasi që kur është votuar buxheti në vitin e kaluar kam propozuar që projektet të shkojn në kode buxhetore pasi që kur votohet një rrugë nuk mundë askush ta ndryshoj e ndërsa kur thuhet asfaltimi i rrugëve lokale e me atë vendim i kan rregullu cilat rrugë kanë dashtë vet.

Kryesusi e hudhi në votim propozimin e Ramush Mehmetit.

Me 10 vota për, 2 kunder (Negovan Jovanovic, Dobrivoje Djordjevic) 2 apstenime, 1 nuk ka qenë prezent aprovohet ky:

VENDIMI

Miratohet Propozim-vendimi, që të bëhet një vizitë pune jasht vendit.

Xhejlane Behluli tha: sa i perket projekteve që propozohen në buxhetin e ardhshëm të ulemi të bisedojm bashk e mos të kemi ditën e fundit paknaqësi si dhe degjimet buxhetore që bëhen ju kisha lut ju si antarë të Kuvendit me marrë pjesë, ju faleminderit.

Zymer Zymeri tha: mirë e tha Naseri pasi si mundet të shkoj Bajrami në fshat të huj ku se njih askend e me i tregu për rrugë, duhet të ftohen njerzit e fshatit dhe nuk ka asgjë të keqe që më thirr Xhejlanen si antare të fshatit ose përfaqësuesin e fshatit Naserin kur kan ndonjë investim dhe në çdo fshat kështu duhet vepruar, ju faleminderit.

Procesverbali i Kuvendit

Selatin Nuhiu tha: unë nuk pajtohem me ankesat e Naser Ibrahimit i cili e akuzon një punëtorë Komunal i cili vetem se i zbaton projektet pasi që ai ka një Drejtor politik dhe një Kryetar Komune dhe kur keni ankesa duhet ti drejtoheni në adres të duhur pasi që ai person vetem i zbaton urdhërat e shefit të vet, ju faleminderit.

Abdyl Gashi tha: po nderlidhem me një rrugë në fshatin Kosaq që është asfaltuar afer 1 viti dhe pothuajse është dëmtuar më shumë se 20 vende dhe sa e di është asfaltuar pre Ministrisë së Transportit prej nivelit qendror por nuk do të thotë se Komuna nuk mundet me bë një ankesë në Ministri për shkak se 1 vit çdo kompani e ka për me mbikqyrë, ju falemionderit.

Xhejlane Behluli tha: i kisha lut koleget serb me na respektu perderisa këta shum pak kyçen ne debate e ne si komunitet shqiptarë me na respektu me prezencen e tyre, ju faleminderit.

Pasi nuk pat diskutime tjera Kryesuesi i falernderoi të pranishmit për pjesëmarrje.
Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Nebojsa Arsic
Kryesues i Kuvendit

